

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9831, DATË 12.11.2007, “PËR DËMSPËRBLIMIT E ISH-TË DËNUARVE POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është mundësimi i së drejtës ligjore që gëzojnë ish të përndjekurit e regjimit komunist, të cilët janë ende në jetë dhe bëjnë pjesë në kategorinë parësore, të përfitojnë të gjithë shumën e miratuar të dëmshpërblimit financiar, sipas parashikimeve të kuadrit ligjor në fuqi. Gjithashtu, nëpërmjet këtij projektligji, synohet edhe përshtetimi i procesit të dëmshpërblimit financiar për familjarët e viktimave të burgosura, të ekzekutuara dhe të internuara.

Ashtu sikurse ligjet e mëparshme amenduese të ligjit nr.9831, datë 2007, të ndryshuar, edhe ky projektligj synon përmbylljen e procesit të dëmshpërblimit për ata ish-të dënuar që kanë vuajtur vetë dënimin gjatë regjimit komunist, si dhe familjarëve të tyre, nëpërmjet gjetjes së mekanizmave eficientë.

Objektivat kryesorë të synuar nëpërmjet këtij projektligji janë:

- përmbyllja përfundimtare e procesit të dëmshpërblimit për ata ish-të dënuar që kanë vuajtur vetë dënimin gjatë regjimit komunist, ende në jetë;
- heqja e raportit të përcaktuar të fondit të miratuar, ku 70% i vihej në dispozicion kategorisë parësore dhe pjesa tjetër i shpërndahej kategorisë së trashëgimtarëve;
- dëmshpërblimi i plotë, për të gjithë ata ish-të dënuar të cilët janë ende në jetë, por që për shkak të kufizimeve aktuale të kuadrit ligjor në fuqi, ku përcaktohet ndarja e shumës së dëmshpërblimit në 8 këste, me vlerë maksimale 1 000 000 (një milion) lekë, nuk kanë marrë gjithë shumën e miratuar të dëmshpërblimit. Ndërkohë që ekzistojnë subjekte parësore, të cilët e superojnë këtë vlerë (8 x 1 000 000 lekë);

Gjithashtu, ky projektligj synon të trajtojë ato subjekte përfituese, vlera totale e miratuar për të cilët është deri në 1 000 000 (një milion) lekë, duke krijuar

mundësinë që të likuidohen në një këst të vetëm, pavarësisht fazës në të cilën ndodhet shpërndarja e dëmshpërblimit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA

Projektligji është në përputhje me zbatimin e objektivave të parashikuar në programin e qeverisë, për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist.

Projektligji është i parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten gjatë vitit 2018, për shqyrtim, pranë Këshillit të Ministrave, miratuar me vendimin nr.37, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i këtij projektligji synon krijimin e mundësisë së përfundimit të shpërndarjes së dëmshpërblimit financiar për ish-të përndjekurit e regjimit komunist, të cilët janë ende në jetë, duke i dhënë prioritet likuidimit të plotë të tyre. Në këtë kuadër, ky propozim vjen në vijim të disa ndryshimeve të mëparshme të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, të kryera në vitin 2014 dhe më tej me amendimet e kryera me anë të ligjit nr.27/2017.

Pas një analize të situatës aktuale, rezulton se kategoria parësore tashmë është likuiduar thuajse në masën 90%, me tetë këstet takuese, ndërkohë që kanë mbetur diferenca e pa likuiduar. Në këtë kuadër, projektligji synon rishikimin e mekanizmit të shpërndarjes së fondeve të vëna në dispozicion, duke i dhënë prioritet likuidimit të plotë të ish-të përndjekurve të regjimit komunist, të cilët janë ende në jetë.

Për realizimin e këtij qëllimi është i nevojshëm rishikimi i raportit të përcaktuar të fondit të miratuar, ku sipas parashikimeve ligjore, 70% i vihet në dispozicion kategorisë parësore dhe pjesa tjetër i shpërndahet kategorisë së trashëgimtarëve, duke limituar në këtë mënyrë mundësinë e akordimit të të gjithë fondit të miratuar kategorisë parësore.

Gjithashtu, nëpërmjet këtyre amendimeve ligjore synohet rregullimi i situatës së subjekteve përfituese, të cilët janë ende në jetë, vlera totale e dëmshpërblimit të miratuar e të cilëve është mbi tetë milionë lekë. Duke mbajtur në konsideratë kriteret ligjore të pagesës, të parashikuara në ligjin nr.9831, datë 12.11.2007, të ndryshuar, ku shpërndarja e masës së dëmshpërblimit, e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, kryhet deri në tetë këste, ku një këst nuk mund të jetë

më i vogël se 100 000 (njëqind mijë) lekë dhe jo më i madh se 1 000 000 (një milion) lekë, lind nevoja e rregullimit të mundësisë së përfitimit të shumës së plotë të dëmshpërblimit për të gjitha subjektet përfituese parësore që janë ende në jetë dhe që e superojnë këtë maksimum të vendosur ligjor.

Një tjetër propozim që vjen në kuadër të shmangies së burokracive dhe të lehtësimit të ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist është edhe likuidimi me anë të një kësti (pagese) të vetme, të të gjithë vlerës totale të dëmshpërblimit, në ato raste kur vlera e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave është deri në 1 000 000 (një milion) lekë.

Efektet e këtij projektligji synojnë të jenë në përputhje me parashikimet e ligjit vjetor të buxhetit 2018, duke mundësuar shpërndarjen e dëmshpërblimit financiar në mënyrë proporcionale, jo duke u bazuar në raportin 30:70, e cituar në ndryshimet e ligjit nr.9831, datë 12.11.2007, të ndryshuar për të vijuar në këtë mënyrë përmbylljen me ritme më të shpejta të shpërndarjes së dëmshpërblimit financiar për familjarët e viktimave të ekzekutuara dhe të burgosura gjatë regjimit komunist, si rezultat i përmbylljes së procesit të shpërndarjes për kategorinë parësore, ende në jetë.

Mbështetur në faktin se dëmshpërblimi është e drejtë jopasurore vetjake, që nënkupton se, kjo e drejtë lidhet vetëm me personin përfitues, ndërkohë, ligji ka kufizuar radhën e familjarëve që përfitojnë dëmshpërblimin, deri tek nipi/mbesa, duke ndërprerë vijimin e dëmshpërblimit në radhët pasardhëse, nëpërmjet këtij projektligji propozohet edhe kalimi i vlerës së dëmshpërblimit në buxhetin e shtetit, në ato raste kur e drejta e përfitimit të dëmshpërblimit financiar përfundon me mbylljen e rrethit të familjarëve që nuk jetojnë, të përcaktuar sipas pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007, të ndryshuar. Ky propozim, është në harmoni edhe me qëllimin e kësaj nisme, e cila konsiston edhe në synimin e përmbylljes sa më shpejt të procesit të dëmshpërblimit, duke zbatuar parimet e buxhetimit, të cilat, ndër të tjera, synojnë përdorimin me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet të burimeve publike.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 83, të Kushtetutës, projektligji i propozohet për shqyrtim dhe miratim Kuvendit, me procedurë të përshpejtuar.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, dhe në përputhje me parimet kushtetuese dhe me legjislacionin në fuqi, duke garantuar të drejtën për dëmshpërblim, transparencë dhe trajtim të barabartë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTARE

Ky projektligj nuk synon përafrimin me legjislacionin *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Nga pikëpamja teknike, projektligji është hartuar në 6 nene.

Nëpërmjet shtimit të pikës 3, të nenit 8, propozohet kalimi i vlerës së dëmshpërblimit në buxhetin e shtetit, në ato raste kur e drejta e përfitimit të dëmshpërblimit financiar përfundon me mbylljen e rrethit të familjarëve që nuk jetojnë, të përcaktuar sipas pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007, të ndryshuar. Ky propozim bëhet me qëllim që nëse shpërndarja e dëmshpërblimit financiar ndërpritet si pasojë e vdekjes së përfituesit të fundit të radhës së fundit të trashëgimisë, referuar radhës së trashëgimtarëve të përcaktuar në nenin 8, të ligjit 9831, datë 12.11.2007, të ndryshuar, pjesa takuese e dëmshpërblimit të tyre të kalojë në buxhetin e shtetit, për sa kohë që dëmshpërblimi është e drejtë jopasurore vetjake dhe qëllimi i kësaj nisme konsiston edhe në përmbylljen sa më shpejt të procesit të dëmshpërblimit.

Një propozim i cili ka një impakt të konsiderueshëm dhe që formalizon dhe normon qëllimin kryesor të kësaj nisme, është amendimi i nenit 12, të ligjit, ndryshimi i të cilit sjell, si më poshtë:

1. Ndryshimin e raportit të përcaktuar të fondit të miratuar, ku 70% i vihej në dispozicion kategorisë parësore dhe pjesa tjetër i shpërndahej kategorisë së trashëgimtarëve;
2. Mundësinë e dëmshpërblimit të plotë, për të gjithë ata ish-të dënuar të cilët janë ende në jetë, të cilët për shkak të parashikimeve aktuale ligjore ishin të kufizuar në marrjen e vlerës maksimale të dëmshpërblimit, pasi parashikimet ligjore e kufizonin ndarjen e shumave në 8 këste, me vlerë maksimale 1 000 000 (një milion) lekë. Ndërkohë që ekzistojnë subjekte parësore të cilët e superojnë këtë vlerë (8 x 1 000 000 lekë), të vendosur nga ligji;
3. Rishikimin e trajtimit të subjekteve përfituese, vlera totale e miratuar për të cilët është deri në 1 000 000 lekë, duke krijuar mundësinë e likuidimit në një këst të vetëm, pavarësisht fazës në të cilën ndodhet shpërndarja e dëmshpërblimit.

Ndryshimi i paragrafit të tretë, të nenit 13 të ligjit, vjen si pasojë e reflektimit të ndryshimeve të sipërcituara dhe të riformulimit që ka pësuar neni 12, mbi mënyrën e shpërndarjes së dëmshpërblimit financiar si dhe raporteve të shpërndarjes së

fondeve buxhetore të miratuara për dëmshpërblimin e subjekteve përfituese, sipas ligjit.

Nëpërmjet nenit 4 të projektligjit, propozohet ndryshimi i nenit 29 të ligjit, duke përcaktuar se, mosmarrëveshjet që lidhen me gabimet e bëra në të dhëna ose në llogaritjen e masës së shpërblimit, ose ndonjë pasaktësi e dukshme në vendimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e dëmshpërblimit financiar, mund të rishikohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Një propozim i tillë synon të evitojë kostot shtesë si dhe të përmbyllë brenda një kohe sa më të shpejtë procesin e dëmshpërblimit të subjekteve respektive.

Në nenin 5 të projektligjit, propozohen ndryshime, me qëllim unifikimin e terminologjisë dhe shmangien e nevojës për amendime eventuale, si pasojë e ndryshimit të fushës së përgjegjësisë shtetërore të institucioneve.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

VIII. MINISTRITË INSTITUCIONET DHE PERSONAT QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga grupi ndërinstitutional i punës, ngritur me urdhrin nr.155, datë 6.12.2017, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk sjell efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE